



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

VENDIM

Nr. 140, Datë 06.09.2017

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBPETROL” SH.A, NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37 pika 2, gërma “d” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “e”; 5, pika 1 gërma “e”; 13 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në Sektorin e Energjisë Elektrike”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullave për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr.96 datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.09.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licencimin e Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut;

Konstatohet se:

Shoqëria “ALBPETROL” sh.a., me shkresën nr. 3322/1 Prot., datë 11.05.2017, protokolluar në ERE me nr. 385/1 prot., datë 12.05.2017, ka paraqitur kërkesën për t’u pajisur me licencënëaktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike.

Bordi i ERE me vendimin nr. 85, datë 07.06.2017, filloi procedurën për licensimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a në aktivitetin e tregtimit të Energjisë Elektrike.

Aplikimi i Shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat (“a/b”, “c” “d” dhe “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

Vendosi:

1. Licencimin e shoqërisë “ALBPETROL” sh.a., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5(pesë)-vjeçar.
2. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE
Petrit AHMETI